



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:025394  
Datë: 19.12.2023  
Numri i dokumentit: 05092434

**C-IV-14-2017**

*Ankuesja*

**R M, Mali i Zi.**

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 18 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ139-0653, datë 12 shkurt 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesen.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 26 mars 2014, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ139-0653, të datës 12 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin vendim ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e saj për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë të paspecifikuar nga NSH, “17 Nëntori” në Pejë (në likuidim). Ankesa kundër vendimit të kundërshtuar është bërë për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht, shkeljeve thelbësore të procedurë dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja pohon se ka qenë viktimë e diskriminimit. Ankuesja më tej pohon se në bazë të përvojës së punës e ka fituar të drejtën për kompensim. Diskriminimi nga vendimi që është marrë thuhet se e njëjta nuk gjendet në listën e pagave në periudhën prej 6 muajsh nga data e privatizimit 23 korrik 2005 dhe se të njëjtës nuk i takon e drejta për kompensim. Ankuesja më tej pohoi se ky vendim në vetë mban diskriminimin në baza nacionale sepse e njëjta në vitin 1999 është larguar nga Peja dhe se

kthimi i saj ka qenë i pamundur kështu që e njëjta nuk e ka fshehur situatën se nuk gjendet në listën e pagave gjatë vitit 2005 sepse të njëjtës i është mohuar e drejta për punë. Ankuesja në mbështetje të ankesës së saj ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Librezën e punës nr.289473 dhe Vendimin e lëshuar nga NSH “17 Nëntori” nr.47 datë 14 gusht 1992.

Me 20 tetor 2016, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka bërë zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontest, Neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 parashikon që ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 70 par.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Për më tepër ankuesja nuk ka bashkangjitur asnjë kopje të vendimit në bazë dhe për zbatim të të cilit parashtron këtë ankesë përpara Dhomës së Posaçme, prandaj ankesa nuk është e plotë pasi që është në kundërshtim me Nenin 60 par.1.6, ankuesi nuk ka bashkangjitur një kopje të vendimit të ankimuar. E paditura më tej pohon se vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 70.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 ankesa në fjalë është e pabazuar. Gjithashtu, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës së tij dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon që një *“ankesë duhet të përmbajë...argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet ankesa”*. Në vend të argumenteve ligjore, ankuesi thjeshtë ka deklaruar se ai nuk pajtohet me vendimin dhe se ky i fundit është kundërtëhënës dhe i pakuptueshëm. E paditura më tej theksoi se Neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 u njeh të drejtën e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna (kanë pësuar humbje/dëm financiar) si pasojë e një veprimi të ndërmarre nga AKP-ja. Ankuesja nuk ka sjellë asnjë dëshmi për të provuar që ajo ishte punëtorë e NSH-së në vitin 2006 dhe përfitonte rrogë nga NSH-ja para privatizimit. Përkundrazi duke u nisur nga kërkesat për rroga të papaguara, rrjedh që ankuesi ka reshtur së punuari për NSH-në shumë vite përpara privatizimit të saj. Në bazë të Nenit 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 ai nuk ka të drejtë të përfitojë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Nga leximi i Nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, kuptohet se ka dy kushte ligjore për të fituar të drejtën për të marrë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës (1) një pushim nga puna i punonjësit (2) i cili duhet të ketë ardhur si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja (ose në lidhje me të). Ankuesja pretendon se ka punuar pranë NSH-së deri në privatizim mirëpo faktet e tilla nuk mbështeten nga arkiva e NSH-së e cila tregon se ankuesi nuk gjendet në listat e pagave për periudhën maj – gusht 2005. Pasi që ankuesi nuk ishte punëtor i NSH-së, AKP-ja duke e privatizuar NSH-në, nuk e ka pushuar atë nga puna. Rrjedhimisht, ankuesja nuk e përmbush kushtin e dytë të parashikuar në Nenin 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 dhe nuk ka të drejtë të merr dëmshpërblim për ndërprerje të marrëdhënies së punës. E paditura më tej pohon se në lidhje me pretendimet e diskriminimit të ngritura nga ankuesja

është e qëndrimit se objekti i vendimit të AL-së dhe për rrjedhojë e procedurave këtu është vetëm kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës dhe se nuk rezulton të jetë dorëzuar një kërkesë nga ankuesja pranë AL e bazuar në diskriminimin. Prandaj, pretendimet për diskriminim dhe argumentet e ndërlidhura me të si dhe çfarëdolloj kompensimi i kërkuar si pasojë e saj janë irelevante për procedurën këtu. E paditura më tej theksoi se në përputhje me Nenin 70 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 objekt i shqyrtimit para Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme në këtë lëndë është shkelja e mundshme ligjore e AL e konstatuar kjo në vendimin e ankimuar të këtij Autoriteti. E paditura është e qëndrimit se objekt i vendimit të AL është vetëm kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës dhe se nuk rezulton ndonjë kërkesë nga ankuesja për diskriminim. AL ka bërë një vlerësim të saktë dhe të drejtë të kërkesës bazuar në ligjet në fuqi dhe nuk ka diskriminuar ndonjëherë ndonjë punonjës apo ish punonjës të NSH-së në këto baza dhe së nëse ankuesja ndihet e diskriminuar duhet të ndjekë hapat e duhur ligjor përmes procedurave përkatëse për të marrë kompensimin në bazë të diskriminimit. Procedurat sa i përket diskriminimit janë të rregulluara me akte të tjera ligjore dhe bien në kompetence të gjykatave të tjera. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Vendimin e kundërshtuar, Listë pagesën e NSH “17 Nëntori” për muajt maj, qershor, korrik, gusht 2005, dhe Kërkesën për emërimin e anëtarëve të AL datë 12 gusht 2016.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesja ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PEJ139-0653, datë 12 shkurt 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë të paspecifikuar nga NSH "17 Nëntori" në Pejë (*në likuidim*). Në ankesën e saj kundër vendimit të kundërshtuar ankuesja prapë nuk ka përcaktuar ndonjë shumë në emër të kërkesës së saj për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës.

Në lidhje me kërkesën e saj për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, ankuesja nuk ka dorëzuar as vendimin e kundërshtuar. Dëshmitë e vetme të dorëzuara në këtë rast nga ankuesja janë librezat e saj e punës dhe një vendim i vitit 1992 lëshuar nga NSH, dëshmi të cilat nuk janë relevante për themelësinë e kërkesës së ankueses për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës. Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesja nuk kishte parashtruar prova relevante as në procedurën e likuidimit tek AL, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së saj në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës si dhe nuk ka përcaktuar asnjë shumë mujore apo totale lidhur me kompensimin e kërkuar. Ankuesja edhe vet ka deklaruar se pas vitit 1999 për shkak të situatës së krijuar nuk ka qenë në gjendje të kthehet në NSH në vendin e saj të punës dhe rrjedhimisht nuk ka punuar në NSH. Dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, iu takon vetëm atyre punëtorëve, marrëdhënia e punës e të cilëve ka pushuar si rrjedhojë e privatizimit apo likuidimit të ndërmarrjes, e që rrjedhimisht ky nuk është rasti, pasi që ankuesja nuk ka qenë duke punuar në NSH në momentin e privatizimit apo likuidimit të saj.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankueses në lidhje me kërkesën e saj për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës veçanërisht pretendimeve të ankueses mbi bazën e diskriminimit por gjen se të njëjtat janë vetëm pretendime përgjithësuese dhe nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, prandaj si të tilla dhe refuzohen.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar